



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 1144/5 prot.

Tiranë më 25.8.2022

Lënda: Mbi bashkërendimin e projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 502, datë 24.06.2020, të Këshillit të Ministrave “Për Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “Regjistri Elektronik i Ekspertëve””

MINISTRISË SË DREJTËSISË

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 4431/4 prot., datë 19.08.2022, protokolluar me tonën me nr. 1144/4 prot., datë 22.08.2022, me anë të së cilës ridërgoni për bashkërendim projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 502, datë 24.06.2020, të Këshillit të Ministrave “Për Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “Regjistri Elektronik i Ekspertëve””, dhe në vijim të komunikimeve shkresore, në vijim gjeni vlerësimin e Zyrës së Komisionerit.

Në vijim të argumenteve të paraqitura nga ana juaj, ritheksojmë se arsyetimi i bërë nga Zyra e Komisionerit i qëndron rigoroz parimit “*lex specialis derogat generalis*” dhe respektimit të hierarkisë së normave duke i dhënë përparësi ligjit të posaçëm material, që në rastin konkret është ligji nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, si dhe kërkesës për përpunim të drejtë dhe të ligjshëm të të dhënave personale në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të përpunimit sipas parashikimeve të Ligjit.

Mënyra e përpunimit të të dhënave personale të gjendjes civile, aksesit në këto të dhëna, si dhe mënyra e ndërveprimit të databazave të tjera me regjistrin kombëtar të gjendjes civile, gëzojnë një rregullim të posaçëm ligjor sipas pikave 2, 2/1 dhe 3 të nenit 3 të ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009, “Për gjendjen civile” i ndryshuar, dhe aktit nënligjor, Udhëzimit të përbashkët nr.463/2020 “Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin” i cili është miratuar në funksion dhe në zbatim të tij.

Kuadri nënligjor i cituar në shkresën tuaj (pra VKM-ja 502/2020) përbën kriterin ligjor mbi të cilin legjitimohet dhe mbështetet nevoja për marrjen e të dhënave nga Regjistri i

Gjendjes Civile, por mënyra e aksesit dhe përpunimit të këtyre të dhënave duhet të kryhet në përputhje me rregullimin e posaçëm.

Për këtë arsye, Ministria e Drejtësisë, në cilësinë e kontrolluesit, në zbatim të pikës 12 të Udhëzimit të përbashkët nr. 463, datë 10.12.2020 “Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile...”, duhet të ndërmarrë masa për paraqitjen e kërkesës për përfshirjen e institucionit në Aneksin 1 (Lista e institucioneve që marrin informacion, baza ligjore përkatëse, lloji dhe sasia e informacionit që jep shërbimi i gjendjes civile dhe mënyra e vënies në dispozicion të këtij informacioni) të këtij Udhëzimi.

Ritheksojmë që ky është një detyrim që buron nga ligji i posaçëm nr. 10129/2009 “Për gjendjen civile” i ndryshuar, dhe legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale, të cilat parashikojnë dispozita konkrete dhe specifike në kuadër të këtij procesi përpunimi të të dhënave personale dhe ndërveprimi databazash me shërbimin e gjendjes civile të cilat duhen respektuar nga çdo kontrollues.

Përkundrejt këtij argumentimi dhe me përmbushjen e tij, Projekt/vendimi konsiderohet konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi



The image shows a handwritten signature in blue ink over a circular official stamp. The stamp contains the text: "REPUBLIKË E SHQIPËRISË", "KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE Mbrojtjen e të dhënave personale", and "DHE Mbrojtjen e të dhënave personale". The signature is written in a cursive style.